



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.36, datë 26.12.2023

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“RINDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE “EMIN DURAKU”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare “Emin Duraku”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 11, datë 26.04.2022 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare “Emin Duraku”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDLIRAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 17/07 / 2024